

Nikollë Shabani, MA¹

UDC:
343:340.114.05(497.7:4-15)

**DREJTËSIA SI IDE PRIJËTARE E SË DREJTËS PENALE DHE
KOMPARACIONI ME LEGJISLACIONET E SHTETEVE
PERËNDIMORE**

**ПРАВДАТА КАКО ВОДЕЧКА ИДЕЈА НА КАЗНЕНОТО
ПРАВО И СПОРЕДБАТА СО ЗАКОНОДАВСТВОТА НА
ЗАПАДНИТЕ ЗЕМЈИ**

**JUSTICE AS A LEADING IDEA OF CRIMINAL LAW AND
COMPARISONS WITH LEGISLATIONS OF WESTERN
COUNTRIES**

Abstract

In democracy, it is necessary to have cooperation and consultation between lawmakers and the community. The legislator drafts laws for the community, therefore these laws should be what the community wants. There should be institutions and procedures to ensure law enforcement. There should be effective institutions and procedures to ensure that government activity to be in accordance with the law. There must be an independent judiciary so that everyone can rely on it to ensure law enforcement. If politics weighs on justice, everyone will avoid the courts and the community will not respect and enforce their decisions. This brings the anarchy. There is a need for an organized and independent legal representation. Access to justice cannot be realized if the citizen does not have the means to maintain his position in a judicial process. Access to the court should be secured without delay and without high costs. "Delayed justice is denied justice ". 10. Implementation

¹ PhD in Law Faculty of Tirana, scientific worker in the F.R. of Germany.

of the law should be conducted in an impartial and equal manner. As you can see the key element for the existence of the rule of law is the law. Without law is impossible any life that aspires to be social, civilized and predictable. Also the great English thinker Hobbs stated that: "there where is no state there is no law" "Justice is a permanent will to give man what he does belong". From these definitions we can reach the definition of the many treated term "criminal justice". Justice is the guiding idea of right: right is just what is right! If criminal law does not serve justice, it is just a simple means of strength and power. Justice is what limits power, strength, against base of unlimited state obligation! Justice for the victim, for the society but also for the perpetrator of the offense! Does the individual feel the criminal right as meaningless, brutal and frightening obligation depends on it and to what extent it is embellished with fair solutions, seen in this prism, is it the justice in the function of human right!

Keywords: right, justice, criminal law, contemporary law, function, criminal offense, criminality, principle, cause, consequences, motivation, consequences, victims, perpetrator of the offense, author, comparisons of international criminal legislation, etc.

1. Kuptimi i drejtësisë dhe së drejtës

Koncepti liberal i së drejtës penale e mbështet në domethënie dhe funksionet e saj si dhe përmbajtjen e instituteve të saj, mbi idenë për drejtësinë. Drejtësia e drejta nuk është metafizike, por kategori reale sociale! Baza e saj është drejtësia njerëzore, respektivisht ndjenja individuale për drejtësi, mbi çka ndërtohet drejtësia popullore dhe universale. E para është e vetëdijes kolektive, kurse e dyta e dimensionit global universal të drejtësisë! Kuptimi kompleks i drejtësisë e përcakton edhe natyrën e së drejtës penale të padrejtë; *vepra bëhet e dënueshme jo për shkak se është e ndaluar, por për arsye se si vepër jo e drejtë është e ndaluar* ! Gjykimi për padrejtësitë u paraprinë ndalesave penalo-juridike, kurse ligjdhënësi duhet të niset nga gjykimi i tillë gjatë vënies së tyre maksima e vjetër romake: "*Prius fuit iustitia quam ius*",! Parim i rëndësishëm i zhvilluar nga jurisprudenca e Strasburgut është nëse ndërhyrja në ushtrimin e lirive dhe të drejtave të njeriut ka qenë e domosdoshme në një shoqëri demokratike dhe nëse kufizimet e bëra ka qenë të përcaktuara me ligj. Këto parime kanë ndihmuar në masë të konsiderueshme autoritetet nacionale në vlerësimet juridike dhe

gjqësore nëse një masë e ndërhyrjes ka qenë e drejtë në pikëpamje të pajtueshmërisë me përvojën jurisprudenciale të Strasburgut duke bërë në këtë mënyrë ndikimin e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut mjaft të rëndësishëm në drejtim të unifikimit të politikës jurisprudenciale në fushën e kufizimeve të lirive dhe të drejtave të njeriut.²

Drejtësia është ide prijëse e së drejtës: e drejta është vetëm ajo çka është e drejtë! Po qe se e drejta penale nuk i shërben drejtësisë, ajo është vetëm mjet i thjeshtë i forcës dhe fuqisë. Drejtësia është ajo çka e kufizon fuqinë, forcën, kundërbazë e detyrimit shtetëror të pakufizuar! *Drejtësi për viktimën, për shoqërinë por edhe për kryesin e veprës!* Vallë individi a do ta përjetojë të drejtën penale si të pakuptimtë, detyrim brutal dhe frikësuese varet nga ajo - vallë dhe në çfarë mase ajo është e zbukuruar me zgjidhje të drejta dhe vallë a është në funksion të drejtësisë njerëzore. Koncepti liberal i së drejtës penale e mbështet domethënien dhe funksionet e saj si dhe përmbajtjen e instituteve të saj, mbi idenë për drejtësinë. Drejtësia dhe e drejta nuk është metafizike, por kategori reale sociale! Baza e saj është drejtësia njerëzore, respektivisht ndjenja individuale për drejtësi, mbi çka ndërtohet drejtësia popullore dhe universale. E para është e vetëdijes kolektive, kurse e dyta e dimensionit global universal të drejtësisë! Kuptimi kompleks i drejtësisë e përcakton edhe natyrën e së drejtës penale të padrejtë; *vepra bëhet e dënueshme jo për shkak se është e ndaluar, por për arsye se si veper jo e drejtë është e ndaluar.*³ Gjykimi për padrejtësitë u paraprinë ndalesave penalo-juridike, kurse ligjdhënësi duhet të niset nga gjykimi i tillë gjatë vënies së tyre maksima e vjetër romake: “*Prius fuit iustitia quam ius*”.⁴ Të definohet **nocioni për drejtësinë** sipas shumicës thuhet është njëjtë rëndë si të definohet çka është realiteti.⁵ Nga aspekti filozofik-juridik, nocioni për drejtësinë korrespondon me fenomenet e shoqërisë, shtetit dhe së drejtës. Sipas shumicës së autorëve drejtësia është thelb, qëllim ose ide prijëse e së drejtës: e drejta është vullneti i drejtësisë.

Në demokraci është e nevojshme që të ketë bashkëpunim dhe konsultim midis ligjvënësit dhe komunitetit. Legjislatori harton ligje për komunitetin, për këtë arsye këto ligje duhet të jenë ajo çka dëshiron komuniteti. Duhet të ketë institucione dhe procedura për të siguruar

² Xhefri, G. Merfi, Xhills, L. Filozofia e së drejtës, Tiranë 1992, f. 5.

³ (*Radbruch, 45!*)

⁴ (*Dig. I. I.!*)

⁵ (*Solberg/Cros, 79*).

zbatimin e ligjit. Duhet të ketë institucione dhe procedura efektive për të siguruar se veprimtaria e qeverisë të jetë në përputhje me ligjin. Duhet të ketë një gjyqësor të pavarur, në mënyrë që secili të mbështetet aty për të siguruar zbatimin e ligjit. Nëse politika peshon mbi drejtësinë, të gjithë do t'i shmangin gjykatat dhe komuniteti nuk do t'i respektojë dhe zbatojë vendimet e tyre. Kjo gjë sjell anarkinë. Nevojitet një përfaqësim ligjor i organizuar dhe i pavarur. Qasja në drejtësi nuk mund të realizohet nëse qytetari nuk ka mjetet për të ruajtur pozicionin e tij në një proces gjyqësor. Qasja në gjykata duhet të sigurohet pa vonesë dhe pa kosto të lartë. “Drejtësi e vonuar është drejtësi e mohuar”. 10. Zbatimi i ligjit duhet të bëhet në mënyrë të paanshme dhe të barabartë. Siç shihet elementi kryesor për ekzistencën e shtetit ligjor është ligji. Pa ligjin është e pamundur çdo lloj jete që aspiron të jetë shoqërore, e qytetëruar dhe e parashikueshme. Gjithashtu mendimtari i madhe anglez Hobsi shprehej se: “Atje ku nuk ka shtet nuk ka ligj”, “Drejtësia është vullnet i përhershëm për t'i dhënë njeriut atë që i takon”. Nga këto përkufizime mund të arrijmë në përcaktimin e termit shumë të trajtuar “drejtësi penale”.⁶

Nevoja dhe ndjenja për drejtësi është vetia themelore antropologjike e njeriut, kurse maksima “*Fiat iustitia, pereat mundus*” Le të kryhet drejtësia, sikur edhe të shkatërrohet bota!. Vlera e kësaj ideje në universin e mendimit njerëzor është ashtu që secili thirret në drejtësi dhe asnjëri nuk guxon ta mohojë.⁷ Dallimi në mes disa aspekteve të nocionit për drejtësinë daton nga Aristoteli dhe Toma Akuini: drejtësia kumulative që i tangon marrëdhëniet në mes individëve; drejtësia distributive që i përket marrëdhënieve dhe anëtarëve të saj; dhe drejtësia legale që e përcakton raportin e individëve ndaj shoqërisë. Objekt i së parës, drejtësia kumulative, është e drejtë e barabartë e tjetrit në marrëdhëniet reciproke në mes njerëzve si individ të pavarur *suum cuique*: asnjëri nuk mund të pretendojë për të drejta më të mëdha për vete nga ato që ia pranon tjetrit! Drejtësia distributive ka të bënë me distribuimin e të mirave të përbashkëta në mes individëve ose grupeve në shoqëri, por jo sipas *suum cuique*, dhe sipas proporcionit aritmetik, por sipas marrëveshjes sociale apo kriterëve tjera sociale. Ashtu, të drejtat e individit varen nga pozita e tij sociale, fuqia ekonomike dhe kriteret tjera sociale. Drejtësia legale ose sociale për dallim nga ajo distributive,

⁶ Thomas Hobsi (1588-1679).

⁷ (qoftë të jetë besimtar apo jo, konservativ apo revolucionar, siç thotë Perelman, 4).

e tangon raportin e individit ndaj shoqërisë, të definuar si kërkesa të qytetarëve që duhet t'i plotësojë shteti: mbrojtja, ndihma sociale, pjesëmarrja në funksionet publike etj.

2. Kriminalizimi, depenalizimi dhe kuptimi esencial juridik

Kriminalizimi është një koncept i cili është trajtuar gjerësisht në literaturën e huaj juridike. Disa autorë e përcaktojnë atë si “proces i cili i transformon sjelljet dhe personat në krime dhe kriminelë”. Natyrisht ky është një proces kompleks, i cili paraqet veçoritë dhe kritikën e tij. Për këtë arsye, autori Paul Cornil thekson se përkufizimi i kriminalizimit nuk mund të kufizohet vetëm në përcaktimin e një veprimi si veprë penale, por përfshin edhe përmirësimin e dënimeve të veprave penale ekzistuese. Kështu, filozofë të së drejtës penale, si Dennis Baker dhe Joel Feinberg, kanë argumentuar se një sjellje e caktuar duhet të kriminalizohet vetëm atëherë kur është e drejtë që të kriminalizohet. Në veçanti, këta teoricienë theksojnë se nevojiten arsye objektive për të treguar nëse është e drejtë kriminalizimi në një rast të caktuar. Arsyeja kryesore që përdoret në këtë rast, është nëse sjellja dëmton të tjerët, por kjo nuk është e vetmja arsye.

Në teorinë e së drejtës penale amerikane, ka pasur shpesh kritika në lidhje me kriminalizimin. Shumë autorë mbështesin idenë se shpesh herë krimet e rënda mbeten të padënuara, ndërsa Kongresi vazhdon të miratojë shkelje të reja në kodin penal federal. Më shumë se 4000 kundërvajtje federale janë shtuar në kodet penale dhe qindra të tjerë në Kodin e Rregullave Federale. Rezultati i këtij kodi penal si labirint është mbipopullimi i burgjeve dhe shpesh të dënuar të pafajshëm. Sipas prof. Vasilika Hysit: “Inkriminimi ose kriminalizimi është procesi nëpërmjet të cilit disa veprime a sjellje që cilësohen si të dëmshme nga ligji; dekriminalizimi është një proces i cili i referohet heqjes së përcaktimit si krime të sjelljeve sociale ose devijuese”. Qëllimi i kriminalizimit është të krijohet një sistem i gjithanshëm i ndalimeve juridiko–penale, sistemi i mbrojtjes nga kriminaliteti. Kompeksiteti i kriminalizimit varet nga shumë faktorë të cilët janë të lidhur me njëri-tjetrin. Kompeksiteti lidhet me llojin e veprimeve që kriminalizohen, të cilët jo doemos janë akte që i shkaktojnë dëm të tjerëve apo kryhen në mënyrë të qëllimshme për të bërë dëm.

Kompeksiteti lidhet gjithashtu me dallimin midis normave dhe vlerave të një shoqërie të caktuar, për shkak të përkatësive fetare, kulturore dhe sociale. Dallimi i këtyre vlerave ndikon në vlerësimin se

cilat veprime ose fakte duhet të kriminalizohen si dhe nivelin e kriminalizimit (krime apo kundërvajtje penale). Kështu p.sh. vrasja dhe vjedhja janë konsideruar që në lashtësi vepra penale dhe dënoshin, natyrisht jo kurdoherë e kudo jeta e njeriut është mbrojtur nga ligji në mënyrë të barabartë.⁸

3. Depenalizimi dhe kompleksiteti juridik

Edhe për depenalizimin në literaturë ka përkufizime të ndryshme, por mjaft të ngjashme me njëri tjetrin. Sipas disa autorëve, depenalizimi është ulja ose heqja e dënimit për veprën penale. Heqja e dënimit, si rregull, bëhet vetëm kur bëhet njëkohësisht me dekriminalizimin e veprës penale. Depenalizimi, shprehet Gianluigi Ponti, konsiston në refuzimin e sanksionit penal p.sh. disa sjellje, të cilat nuk meritojnë të konsiderohen shtrënguese që t'i përkasin sistemit të dënimeve". Depenalizimi synon në analizë të fundit që t'i gjejë ilaç hipertrofisë së legjislacionit penal. Sipas autorëve të tjerë "depenalizimi është moszbatimi i ligjit për kryerjen e veprave të kriminalizuara ose forma të tjera të lirimit nga përgjegjësia penale ose dënimi". Por ky përkufizim i është nënshtruar kritikës, sepse nuk kuptohet "moszbatimi i dënimit". Ka edhe autorë që dallojnë tri forma të depenalizimit: e para lidhet me shkurtimin e sferës së shtrëngimit penalo–juridik nëpërmjet përjashtimit të veprës nga kategoria e veprave penale; e dyta zgjerimi i mundësisë së lirimit nga dënimi penal për një rreth të gjerë veprash; e treta, në humanizmin e dënimit penal, në radhë të parë të dënimit me burgim. Mirëpo kundër kësaj pikëpamje shprehet një autor tjetër që thotë se forma e parë ka të bëjë me dekriminalizimin dhe jo depenalizimin. Depenalizimi si e kundërta e penalizimit do të thotë ngushtim i kufijve

⁸ Nocioni për drejtësinë është i lidhur me nocionin për të mirën, që është kategori eliminuese morale! E drejta romake e ka nxjerrë këtë nocion nga nocioni për drejtësinë, duke e definuar si "*ars boni et aequi*" (Dig., 1,1,1: Paulus, Ulpian i Celsius). Ulpian e ka definuar drejtësinë si "*ius suum cuique tribuere*", dhe i ka përcaktuar më kryesorët "*praecepta iuris*": "*honeste vivere, alterum non laedere, suum cuique tribuere*" (Dig., 1,1,10,1). Nga këtu e para "*praecepta*" e së drejtës është ndershmëria, që do të thotë aprovim i kodit moral. Futja e komponentit moral e thellon dallimin në mes drejtësisë si ideal dhe realitetit shoqëror të disharmonisë dhe konfliktet të mëhershme në mes grupeve të ndryshme sociale. Për shkak të asaj, duke i regjistruar nga postulatet morale, disa autorë drejtësinë e shpjen mu në çështjen e ekuilibrit social, modus vivendi dhe harmonizimin e interesave antagonistë (Dabin, 357).

të shtrëngimit shtetëror për kryerjen e veprës penale, që shoqërohet nga lirimi nga përgjegjësia penale, me përjashtim të disa dënimeve.

Të drejtat e mbrojtura që ndëshkon krimet kundër jetës dhe personit janë ndër vlerat më themelore që mbrohen, jo vetëm nga e drejta kombëtare, por edhe nga aktet ndërkombëtare, si KEDNJ-JA apo Pakti për të Drejtat Civile dhe Politike. Rëndësia për mbrojtjen dhe respektimin e tyre është një detyrë e epërme e organeve shtetërore, të cilat duhet të marrin masa të përshtatshme për të mbrojtur jetën dhe personin qofshin ato çështje të sigurisë, të shëndetit publik. Duhet të shmanget tendenca dhe orientimi i politikës penale drejt kufijve minimalë ligjorë të llojit e masës së dënimit penal, e cila jep mesazhin më negativ, sepse sulmon drejtpërdrejt dhe në mënyrë agresive sigurinë publike të qytetarëve. Kjo lloj politike asgjëson qëllimet e dënimit penal, qoftë në planin e posaçëm për riedukimin e të dënuarit, qoftë edhe në planin e përgjithshëm për parandalimin e këtyre veprave penale. Ky konkluzion mbështetet edhe nga statistikat, të cilat tregojnë se një set veprash penale që përfshihen në kreun II të Pjesës së Posaçme të Kodit Penal janë në rritje. Reagimi i institucioneve publike në këto raste duhet të jetë i koordinuar dhe efektiv.⁹

4. E drejta penale, i mbron vlerat dhe të mirat reale në raportet shoqërore

Nga ana tjetër duhet të pranohet fakti se e drejta penale, i mbron vlerat dhe të mirat reale në raportet shoqërore të pabarazisë sociale, duke shpallur barazi të pabarabartëve. Kontradiksioni i tillë i brendshëm rezulton nga vetë natyra e drejtësisë: nëse është shprehja e saj reale e jashtme veprimi i barabartë me secilin, barazi e kryesve për veprat penale para ligjit, tendencë e saj e përealizuar është përpjekja kah barazia sociale dhe “*shanset e barabarta*”. Ai shtrëngim i brendshëm fut dinamizëm në vetë konceptin për shtetin juridik që pasqyrohet edhe mbi të drejtën penale. Për të drejtën penale në shikim të parë kontradikta e këtillë e nocionit për drejtësinë është jorelevante, për arsye se ajo ka lëndë tjetër, relacionin specifik: *krimineli dhe ligji*, ashtu që mund të konstatohet se postulati për drejtësinë është i kënaqur me shpalljen e parimit të barazisë para ligjit! Por, sërish kjo komponentë e brendshme dinamike e drejtësisë, si drejtësi sociale i determinon vlerat dhe institutet themelore të së drejtës penale! Vallë ndalesat penalo-juridike do të

⁹ Ponti, G. dhe Merzagora Betsoi, I. Compendio di criminologia, quinta edizione, Raffaello Cortina Editore, Milano 2008, f. 463

vendosen në funksion të mbrojtjes së privilegjuar të vlerave dhe të mirave të caktuara në relacion në të cilin ekziston qasje e kufizuar dhe shanse jo të barabarta për të gjithë qytetarët? Vallë mbrojtja penalo-juridike do të vendoset ashtu që do t'i nxit shanset e barabarta, apo sidomos do të mbrojë vlera të strukturave të caktuara (siç ishte në sistemin tonë të mëhershëm, shembulli me mbrojtjen e veçantë të pronës shoqërore), apo një grup të caktuar social (diskriminimi i qytetarëve në bazë sociale, nacionale, fetare etj.)? Në këto pozita mund të zgjidhet edhe pyetja kryesore në vijim: nëse në një shoqëri të drejtë (në liri dhe të drejta të barabarta dhe shanse të barabarta!) qytetarët janë të obliguar t'iu nënshtrohen ligjeve, ashtu që ai që do ta shkelë ligjin duhet të dënohet, çka do të ndodhë po qe se vetë ligji nuk është i drejtë? Ose po qe se shkakton konsekuenca jo të drejta në rastin konkret? Padrejtësia e ligjit nuk është shkak për mosrespektimin e tij! Ndalesat penalo-juridike duhet të respektohen pa marrë parasysh a shpijnë kah zgjidhje jo të drejta: nuk është e drejtë ta dënojmë atë që vjedh për shkak të varfërisë, por sjellja e tij duhet të trajtohet si vjedhje! Kompetente është vetëm shkalla e padrejtësisë së strukturës themelore shoqërore, kurse me të edhe të vetë ligjit, ashtu që nëse ajo strukturë në bazë është e drejtë atëherë duhet të zbatohet edhe ligj jo i drejtë! Vetëm nëse ai kufi është i tejkaluar, nëse ligji jo i drejtë penal bëhet instrument i shoqërisë së padrejtë, respektivisht ngrihet në sipërfaqen e të padrejtës ligjore, jo vetëm që na detyron, por edhe e aktivizon të drejtën e mosdëgjueshmërisë qytetare dhe hedhjen e strukturës së tillë të padrejtë shoqërore!¹⁰

5. Natyra subsidiare dhe fragmentare e së drejtës penale

Funksioni mbrojtës i së drejtës penale paraprakisht është i kufizuar! Ajo nuk është instrumenti më i fortë për pengimin e kriminalitetit, për arsye se rrënjët e kriminalitetit janë të mbjella në vetë strukturën sociale dhe kundërthëniet sociale, të cilat e drejta penale nuk mund t'i kontrollojë dhe t'i korrigjojë! Kriminaliteti para së gjithash është *fenomen konstant* që e ndjek zhvillimin shoqëror duke filluar prej shoqërive primitive e deri më sot. Çështja për pandryshueshmërinë e tij paraqet enigmë të pazgjidhshme edhe për mendimin bashkëkohor shkencor. Jo vetëm që nuk vjen deri te humbja dhe zvogëlimi i tij në zhvillimin e

¹⁰ Shtrohet pyetja: Vallë mbrojtja penalo-juridike do të vendoset ashtu që do t'i nxit shanset e barabarta, apo sidomos do të mbrojë vlera të strukturave të caktuara siç ishte në sistemin tonë të mëhershëm, shembulli me mbrojtjen e veçantë të pronës shoqërore, apo një grup të caktuar social diskriminimi i qytetarëve në bazë sociale, nacionale, fetare etj.?

kursit ekonomik, kulturor dhe civilizues por përkundrazi ai fiton gjithnjë dimensione më të reja dhe forma fenomenale, duke u rritur në fillim të mileniumit të ri në kërcënim thelbësor për kualitetin e jetës së njeriut dhe zhvillimit shoqëror!

Në kushte të tilla mbrojtja penalo-juridike as prej së largu nuk mund ta kënaq nevojën që të merren masa komplekse shoqërore të parandalimit dhe represionit të kriminalitetit. Represioni gjithashtu varet nga e drejta penale vetëm në masë në të cilën ajo merret me kriminalitetin e zbuluar. Nëse merret parasysh fenomeni “kriminaliteti i fshehur” ose “numri i panjohur i kriminalitetit” që sipas kërkimeve kriminologjike është shumë më i madh nga kriminaliteti i zbuluar, atëherë shfaqja për potencialet e vërteta të mbrojtjes penalo-juridike bëhet edhe më pesimiste.

Qasja e këtillë realiste është bazë për dy përfundime. E para, e drejta penale duhet t’i adaptojë metodat e veta të njohurisë se paraqet “*ultima ratio*”, mjet i fundit dhe paraprak i kufizuar për pengimin e kriminalitetit, pa ndonjë shans të madh të kompensojë diçka që është e lëshuar në planin e parandalimit ose zbulimit të kriminalitetit! Sipas saj mbrojtja penalo-juridike ka natyrë subsidiare, ajo aktivizohet për shkak të mospësuksit të mekanizmave parandalues, drejtuar në radhë të parë kah eliminimi i shkaqeve të kriminalitetit. E drejta penale më së shpeshti intervenon si mjet aksesor për ta siguruar respektimin e normave tjera juridike dhe ka rol të “rojtarit të së drejtës” E dyta, ndalesat dhe sanksionet e saj nuk mund të trajtohen si shpëtimtare, instrumente magjike që do t’iu përgjigjen kërkesave të shoqërisë, për pengimin e kriminalitetit. E drejta penale me instrumentet e veta nuk mund ta eliminojë kriminalitetin, por mund ta mban nën kontroll të caktuar dhe në korniza të kufijve tolerantë me norma që e legjitimojnë reaksionin e detyruar shtetëror.

6. Mbrojtja penalo-juridike karakteri dhe praktika gjyqësore

Mbrojtja penalo-juridike përveç karakterit subsidiar ka karakter fragmentar. Ajo mbulon vetëm rreth të caktuar të të mirave juridike dhe vetëm forma të caktuara të sulmit ndaj atyre të mirave.¹¹ Jashtë rrethit të represionit penal juridik mbesin format e sjelljes që ndoshta janë të dëmtueshme për të mirat juridike siç është alkoolizmi, pirja e duhanit, narkomania ose prostitucioni! Por këto trajtohen si dukuri socio-

¹¹ (Fiandaca/Musco, 32).

patologjike, kurse në veprimin e tyre të dëmshëm mbi shëndetin e njerëzve dhe vlerave tjera individuale dhe shoqërore pengohet ekskluzivisht me masa parandaluese dhe shëruese. Për vënie në veprim mekanizmin represiv të së drejtës penale, sipas saj nuk është çdoherë zgjedhës kriteri i shkallës së lartë të të padrejtës ose dëmit social të vetë sjelljes, përndryshe në të vërtetë ligjdhënësi udhëhiqet mu nga kriteri i tillë në lëshimin e ndalesave penalo-juridike! Ndonjëherë shtrëngon qëndrimi pragmatik i tolerancës kah sjelljet të cilat nuk janë më përjashtim, por janë bërë dominuese ose aq prezentë sa që shoqëria është mësuar në to dhe i toleron edhe përkundër dëmit të tyre! Ashtu është rasti edhe me të gjithë fenomenet të lartpërmendura socio-patologjike, në të cilat ndalesa ligjore edhe pse ekziston mbetet pa asnjë efekt ashtu ligji ynë për ndalimin e pirjes së duhanit në vendet publike dhe dispozitat e tij kundërvajtëse! Në rast të tolerimit të qëndrueshëm të fenomeneve të tilla është e nevojshme periudhë më e gjatë relative e ndikimit mbi vetëdijen shoqërore për ndryshim të qëndrimeve sociale kah ato, që më pastaj krijon hapësirë për intervenim penal.

Karakteri subsidiar dhe fragmentar i mbrojtjes penalo-juridike në mënyrë konsekuente rezulton me parimin e “*ekonomizimit të dënimit*”¹². Si sanksion më i rëndë me të cilin disponon sistemi juridik, dënimi duhet të zbatohet ekskluzivisht vetëm kur është i domosdoshëm për mbrojtjen e të mirave juridike. Pa zbatimin e tillë, represioni penal juridik shpejt e humb kuptimin e vet, për arsye se ekskluzivja, ajo që duhet të gjykohet dhe dënohet është bërë rregull, dhe nuk shkakton më asnjë efekt të veçantë. Teknologjia e represionit joracional, jomodern dhe të gjerë është metodë e dukshme klasike e sistemeve autoritare dhe totalitare: me dënimin masiv të lirisë personale të shkaktohet gjendje e veçantë psikologjike e shtangies dhe apatisë, në të cilën njerëzit në hulumtim pas *modus vivendi* e pranojnë edhe dënimin si fat personal nga i cili nuk ka braktisje! Por parimi i ekonomizimit të dënimit mund të jetë i lëshuar edhe në sistem që përpiqet t’i respekton parimet e shtetit juridik.

7.2. Natyra autonome e së drejtës penale

Ekzistojnë dy koncepte. Sipas të parit, për *natyrën aksesore të së drejtës penale* ajo nuk është e pavarur, paraqet lidhje kah degët tjera juridike dhe raport me to ka qëndrim ndihmës, sekondar! Ky koncept mbështetet mbi natyrën subsidiare e mbrojtjes penalo-juridike e drejta

¹² (Maiwald, 21).

penale si *ultima ratio societatis*. Ajo nuk ka objektet e veta autonome mbrojtëse, por paraqet mënyrë e posaçme të mbrojtjes së vlerave individuale dhe shoqërore, të cilat në mënyrë primare dhe origjinare janë të mbrojtura me degat tjera juridike. Po qe se vëzhgohet funksioni mbrojtës mund të gjenden shumë argumente në favor të qëndrimit të këtyllë. Ashtu p.sh., e drejta penale mbron: pronën, marrëdhëniet ekonomike, detyrën zyrtare, financat publike etj., të cilat janë lëndë të rregullativës së degëve tjera juridike e drejta civile, e drejta administrative, e drejta financiare etj. Marrëdhëniet juridike si dhe vlerat të cilat janë lëndë të atyre marrëdhënieve janë të rregulluara me degët tjera juridike përkatëse që përmbajnë sistem zhvillues të mbrojtjes së tyre administrative ose gjyqësore. Gjithashtu të drejtat dhe liritë e njeriut janë lëndë të konventave ndërkombëtare, të vet Kushtetutës ose rregullativës ligjore me të cilën janë të përpunuara mekanizma të ndryshëm për mbrojtjen e tyre. Del se për të drejtën penale mbetet krejtësisht hapësirë e kufizuar, në të cilën ajo intervenon me ndalesat dhe sistemet e veta të sanksioneve po qe se bëhet fjalë për ndonjë sulm ekskluziv mbi të mirat mbrojtëse, kurse intervenimi i saj është e vendosur në funksion të përkrahjes, përforcim të mbrojtjes primare që e sigurojnë degët tjera juridike!

Por punët duhet të hulumtohen nga ndonjë kënd tjetër! Nga pikëpamja historike normat penalo-juridike hyjnë në rrethin e normave më të vjetra juridike. E drejta penale është më e vjetra nga degët tjera juridike, që mund të llogariten për çerap që janë rritur nga një trung i fortë rrënjor, funksioni i së cilës ka qenë ta përforcojnë dhe zgjerojnë mbrojtjen elementare e vlerave penalo-juridike! Nga ana tjetër edhe sot ekzistojnë vlera siç është dinjiteti njerëzor, jeta, integriteti trupor, nderi dhe autoriteti, liria gjinore etj., që janë të mbrojtura me të drejtën penale! Nga këtu dhe shkalla e ndryshueshme e lidhjes se e drejtës penale me degët tjera dhe theksimi në plan të parë të mbrojtjes penalo-juridike ose të mbrojtjes tjetër juridike. Po qe se shkohet nga funksioni mbrojtës më gjatë dhe më gjerë mund të problematizohet teza për natyrën autonome e së drejtës penale. Por po qe se vëzhgohet mënyra, metodat dhe mjetet me të cilat e drejta penale e plotëson funksionin mbrojtës, natyrën autonome dhe qëndrimin e saj në sistemin juridik është më tepër nga jokonfliktuoze. Me degët tjera ekzistojnë fije të përbashkëta dhe ndikim reciprok, sepse edhe e drejta penale është pjesë e sistemit juridik, i cili pas definimit nuk pëson zbrazëtira të brendshme ose kundërthënie. Por për të drejtën penale karakteristike është qasja e

bazuar socio-etike kah çështja e përgjegjësisë dhe sanksionit si dhe karakteri i tyre publik juridik, përgjegjësia e kryesit para shtetit ashtu në mënyrë eksplicite në të drejtën anglo-saksone procesi penal formalisht e definon si konflikt në mes i akuzuarit dhe shtetit, dënimi në emër të drejtësisë. Qëndrim i tillë e sqaron mundësinë konfliktin dhe suprimimin në lidhje me degët tjera ashtu, roli i të dëmtuarit në një mënyrë është i përcaktuar në e drejtën civile, kurse në mënyrë tjetër në e drejtën penale.

7. Legjislacionet e vendeve perëndimore dhe konventat ndërkombëtare

Konventa jep përkufizimin e veprës penale si “aktet që janë trajtuar nga e drejta penale dhe ato të trajtuara nga dispozitat ligjore të renditura në shtojcën III të kësaj Konvente me kusht që në rastin kur një autoritet administrativ ka kompetencën që të merret me veprën penale, personi i interesuar duhet të ketë të drejtën që çështja e tij të gjykohej nga një gjyq”.

Konventa e Këshillit të Evropës “Për ndihmën e ndërsjellë juridike në fushën penale”. Ndihma e ndërsjellë midis dy shteteve shtrihet në fushën gjyqësore në të gjitha procedurat që lidhen me veprat penale. Palët kontraktuese angazhohen të japin në mënyrë të ndërsjellë, sipas dispozitave të kësaj Konvente, një bashkëpunim sa më të gjerë gjyqësor në çdo rast procedimi që lidhet me krimet në të cilat shtrëngimi është, që nga momenti në të cilin është kërkuar ndihma, kompetencë e autoriteteve gjyqësore të palës kërkuese. Kjo Konventë nuk zbatohet as gjatë ekzekutimit të masës së arrestit dhe të dënimeve dhe as për krimet ushtarake që nuk përbëjnë krime të së drejtës së përgjithshme.

Format e bashkëpunimit janë: Letërporositë. Ato përbëjnë një kërkesë të bërë nga autoriteti gjyqësor i një shteti kërkues, drejtuar një autoriteti të një shteti tjetër i kërkuari dhe që synon kryerjen për llogari të tij, të një hetimi: ekspertizë, dëgjimi i një personi ose sequestrim i një sendi. Pra është një mandat gjyqësor ekzistenca e të cilit është e domosdoshme meqenëse sipas parimit të sovranitetit autoriteti gjyqësor kërkues nuk mund ta shtrijë veprimtarinë e tij jashtë kufijve të tij dhe nuk mund të kryejë hetime në një shtet tjetër pa autorizimin e tij. Pala, së cilës i drejtohet kërkesa, do të ekzekutojë, sipas procedurave të parashikuara nga legjislacioni i vendit të saj, letërporositë që lidhen me një procedim penal që do t'i drejtohen asaj nga autoritetet gjyqësore të palës kërkuese.

8. Konventa Evropiane “Për pastrimin, depistimin, kapjen dhe konfiskimin e produkteve të krimit”

Kjo konventë ka për qëllim privimin e kriminelëve nga produktet e krimit me anë të ngritjes së një sistemi bashkëpunimi ndërkombëtar. Shtetet duhet të përshtatin masat ligjore dhe masat e tjera që rezultojnë të nevojshme për të lejuar konfiskimin e instrumenteve dhe produkteve ose pasurive, vlera e të cilave u përket produkteve të veprës penale. Shtetet kanë gjithashtu detyrimin të përshtatin masat ligjore dhe masat e tjera që rezultojnë të nevojshme për t’i atribuar aktit karakterin e veprës penale konform të drejtës së brendshme kur akti është kryer qëllimisht për: a. kthimin ose transfertën e pasurive, për të cilat, ai që i bën, e di që këto pasuri përbëjnë produkte me qëllim që të fshihet ose të maskohet origjina e paligjshme e pasurive të tilla ose që ndihmon çdo person që është i ngatërruar në kryerjen e veprës penale kryesore për t’u shpëtuar pasojave juridike të akteve të tij; b. fshehja ose maskimi i natyrës, origjinës, vendndodhjes, disponimit, zhvendosjes ose pronësisë reale të pasurive ose të drejtave të lidhur me to, për të cilat autori është në dijeni që këto pasuri përbëjnë produkte; dhe, me rezervën e parimeve kushtetuese të saj dhe të koncepteve themelore të sistemit juridik; c. të fituarit, mbajtja ose përdorimi i pasurive, të cilat, ai që i fiton, i mban ose i përdor, është në dijeni, në kohën kur ai i merr, se ato përbëjnë produkte; d. pjesëmarrja në njërën nga veprat penale të treguara konform këtij neni ose çdo shoqërim, marrëveshje, tentativë ose bashkëpunim me anë të dhënies të pranisë, të ndihmës ose të këshillave për kryerjen. Shtetet bashkëpunojnë me njëri-tjetrin sa më shumë që të jetë e mundur me qëllim të hetimeve dhe procedimeve që synojnë konfiskimin e instrumenteve dhe të produkteve.

Conclusion

Relying on the national and international criminal practice, we can conclude that the autonomy of criminal law is seen by the fact that, relying on the specific function and means with which is served to fight the criminality, independently defines its notions and this helps the national rights of the least developed countries where criminality is most emphasized in these countries. In some cases criminal-law protection completes the protection of relationships and of certain goods such as the right to property, it is a subject of legal civil law, while criminal law sanctions those forms of attack that are characterized with violence, fraud or other trainings, different from the usual ways of continuation

or the dismissal of the civil legal relationship in that sense is incriminated theft as a forced rest of the rule of affairs, fraud as misuse of trust in disposing of property that unfortunately these actions are very current in some Balkan countries that in practice do not get the proper epilogue on the return of stolen items but it is recommended damaged parties to sue with civil-legal contestations. Nevertheless, in these cases the criminal law often adapts these notions, the specific nature of its protective function. So, for example, the notion of "movable foreign property" used at theft has a different meaning from the legal civil definition of that notion according to which as a real estate are treated and the waste of real estate for the criminal law as a movable item is each item that can be eradicated, displaced, so it is not excluded even real estate in the legal juridical sense. By concluding this scientific paper we can conclude that the quality of the criminal law is and remains another element that demonstrates effectiveness and means a satisfactory level of legal technique, the harmonization of various articles of criminal law and penal sanctions, the harmonization of criminal law with other legal acts of different branches of law, to provide solid grounds for criminalization, decriminalization or penalizing the criminal offense both in terms of national and international law.

Bibliografia

- Altin Dr. Shegani, "Drejta Penale e Krahasuar" .DARMISA, 1999. Heller, K. J & Dubber M.D. The Handbook of Comparative Criminal Law. Stanford University Press, 2011.
- Bashkim Dr. Selmani " Krimi i organizuar dhe terrorizmi ndërkombëtar"-Universiteti parë privat "Fon"-Shkup, 2010.
- Bashkim Dr. Selmani & Mevledin Dr. Mustafi "Sistemet e sigurisë sistema securita" Shtëpia botuese Furkan-Ism, Shkup, 2016.
- Bekaert, H., Introduction a l'étude du droit, Deuxième édition, Bruxelles 1965;
- Bockelmann, P., Studien zum Täterstrafrecht, 1. Teil, Berlin 1939;
- Brandon, S.G.F., Gjykimi i Jezusit nga Nazareti, Shkup 1988;
- Brantingham, P. and Faust, F., A Conceptual Model of Crime Prevention, në: Rutherford, Criminal Policy Making;
- Brown, J. et Jammes, J., La prévention de la criminalité: à la recherche de concepts et de stratégies, RSC 1980/4;

- Currie, E., Social crime prevention strategies in a market society, në: Muncie/McLaughlin/Langan;
- Çokrevski, T., Sociologjia e së drejtës, Shkup 1996;
- Dabin, J., Théorie générale du droit, Paris 1969; Europe in a Time of Change: Crime Policy and Criminal Law, Council of Europe, Recommendation No.R (96)8 and explanatory memorandum and report on responses to developments in the volume and structure of crime in Europe in a time of change, Strasbourg 1999;
- Feeley, M. and Simon, J., The new Penology, në: Muncie-/Laughlin/Langan, Criminological Perspectives, A Reader, London 1996; Goutal, J.-L., L'autonomie du droit pénal: reflux et métamorphose, RSC 1980/4;
- Hall, S., Drifting into a law and order society, në: Muncie-/McLaughlin/Langan; Hassemer, W., Konstanten kriminalpolitischer Theorie, Festschrift f. R.Lange, Berlin 1976;
- Hirsch, H. J., Zur Abgrenzung von Strafrecht und Zivilrecht, Festschrift f. K. Engisch, Frankfurt am Main 1969;
- Kaiser, G., Entëicklungstendenzen des Strafrechts, Festschrift f. R.Maurach, Karlsruhe 1972;
- Kajzer, G., Kriminologjia, Shkup 1955;
- Kambovski, V., 7, Bazat dhe drejtimet e reformës të së drejtës penale të Maqedonisë, MRKK 1994/1;
- Kambovski, 8, Mbrojtja autoritare e lirive dhe të drejtave të njeriut dhe qytetarit në përmbledhjen: Liritë dhe të drejtat e njeriut dhe qytetarit, Shkup 1984;
- Karanikas, D., Le role social-pédagogique du droit répressif, RIDP 1967/1-2;
- Kaufmann, (Arthur), Uporaba Radbruchove formule o zakonskem nepravu in o nadzakonskem pravu pri razpravljanju o krivicah, ki so bile storjene v imenu Nemške Demokratične Republike, Pravniki Lj., 1996/9-10;
- Vorpsi, A. Procesi i rregullt ligjor në praktikën e Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë, Tiranë 2011 106.